



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Drejtoria e Bujqësisë

THIRRJE PËR APLIKIM

I. Përkrahje në blegtori – pagesa direkte

Njoftohen të gjithë fermerët e komunës së Prishtinës, të cilët posedojnë gjedhe qumështore, si dhe kafshë të imëta - dele dhe dhi, se mund të aplikojnë për subvencione në lëmin e blegtorisë - pagesa direkte.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

Përkrahen fermerët që kanë:

- 3 - 10 krerë gjedhe (lopë qumështore);
- 20 -150 krerë dele;
- 20 - 150 krerë dhi;
- Kafshët duhet të jenë të matrikuara;
- Përfituesi duhet të jetë banorë i komunës së Prishtinës;
- Objekti (stalla) të jetë në territorin e komunës së Prishtinës.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues të vlefshëm të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi i llogarisë bankare;
- Vërtetim nga shërbimet veterinare;
- Vërtetimi mbi tatimin në pronë për vitin 2021;
- Numri identifikues i fermerit (NIF).

Aplikimi, nga 01.03.2022 deri më 18.03.2022

II. Përkrahje në bletari - pagesa direkte

Njoftohen të gjithë fermerët e komunës së Prishtinës, të cilët posedojnë bletë, se mund të aplikojnë për subvencione në lëmin e bletarisë - pagesa direkte.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë bletarët/aplikuesit:

- Përkrahen bletarët që kanë 10 - 29 shoqëri bletësh;
- Përfituesi duhet të jetë banorë i komunës së Prishtinës dhe të ketë bletoren në territorin e Komunës së Prishtinës;
- Përfituesi - bletarët duhet të kenë të shenjzuara kosheret (shtëpizat e bletëve);
- Numri identifikues i fermerit (NIF) duhet të jetë i vendosur në shabllon, në përmasat 30x12 cm, në trupin e kosheres, jo në kapak, i shënuar me ngjyrë të përhershme.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues të vlefshëm të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi i llogarisë bankare;
- Vërtetimi mbi tatimin në pronë, për vitin 2021;
- Numri identifikues i fermerit (NIF).

Aplikimi, prej 01.03.2022 deri më 18.03.2022